



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 327

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT, TË SUBJEKTIT
VETËDEKLARUES Z. ARJAN LIMAN XHETA, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN BASHKIAK, I
PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA DEMOKRATIKE", BASHKIA BULQIZË**

Sot më datë 12.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

OBJEKT: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të subjektit vetëdeklarues z. Arjan Liman Xheta, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike", për Bashkinë Bulqizë.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 5 dhe 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi

Data 12.4.2023 Nr: 327
Ora:12:00



'Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të subjektit vetëdeklarues z. Arjan Liman Xheta, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike", për Bashkinë Bulqizë".

kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte, ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtar në këshillin bashkiak.

Me vendim të KZAZ-së, z. Arjan Liman Xheta, është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike", për Bashkinë Bulqizë.

Për këtë kandidat, në datën 2.4.2023, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar formulari e vetëdeklarimit, i cili, është regjistruar me nr. unik DI-PDSH-17611. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPGJ).

Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, DPGJ informon se kandidati në fjalë, nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Arjan Liman Xheta, rezulton:

- Në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjeneralitete të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka ndryshim tek gjeneralitetet e tij, Emri i mëparshëm: Rahman
- Në rubrikën III. "TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT", të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 "A jeni dënuar ndonjë here me vendim gjyqësor të formës së prerë?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", Gjykata e Belgjikës, në vitin 1999, ka marrë masë "arrest me burg" rreth 3 muaj, për arsye dokumentacioni.
- Pyetjes 3 "A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoriteti i huaj, për kryerjen e një vepre penale?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", Gjykata e Belgjikës në vitin 1999, për arsye dokumentacioni.
- Pyetjes 4 "A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerje e një vepre penale?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", Gjykata e Belgjikës në vitin 1999, për arsye dokumentacioni.
- Pyetjes 5 "A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?" subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", është caktuar masa "arrest me burg".
- Pyetjes 7 "A është marrë ndonjëherë për ju, masa e dëbimit nga një shtet i huaj?" subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", Gjykata e Belgjikës në vitin 1999, për arsye dokumentacioni.
- Pyetjes 8 "A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO", në vitin 1999, ka qenë emigrant në Belgjikë, dhe në vitin 2017, ka qenë emigrant në Itali.

Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve si më sipër në formular, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë, në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja.

Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se, për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisionit Qendror i Zgjedhjeve nuk ka kompetencën për të kryer verifikime. Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Arjan Liman Xheta, kandidat për këshillin bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” për Bashkinë Bulqizë, dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data:12.4.2023 Nr: 327
Ora:12:00



“Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të subjektit vetëdeklarues z. Arjan Liman Xheta, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, për Bashkinë Bulqizë.”